



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:202186
Datë: 05.09.2024
Numri i dokumentit: 06124790

PAKR.nr.119/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për të Krime të Rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Xhevdet Abazi, kryetar i kolegjit, Hashim Çollaku dhe Mentor Bajraktari, anëtar, me bashkëpunëtoren profesionale Nderime Shkodra, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarve, Sh.I., nga Gjilani, për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge, nga neni 267 par.1 të KPK, dhe M.K., nga Gjilani, për shkak të veprës penale posedimi i pa autorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge, nga neni 269 par.1 të KPK, duke vendosur sipas ankesave, të Prokurorisë Themelore në Gjilan, mbrojtësve së të akuzuarve, Sh.I., av.Fitim Kosumi dhe M.K., av.Musli Maloku, të ushtruara kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.194/2023, të dt.18.12.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me dt.04.09.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohen si të pabazuara ankesat, e Prokurorisë Themelore në Gjilan, si dhe mbrojtësve së të akuzuarve, Sh.I., av.Fitim Kosumi dhe M.K., av.Musli Maloku, kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.194/2023, të dt.18.12.2024, vërtetohet.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.194/2023, të dt.18.12.2024, janë shpallur fajtor të akuzuarit,

- Sh.I., për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge, nga neni 267 par.1 të KPK, dhe i është shqiptuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 1(një)viti, si dhe dënimin me gjobë në shumën prej 600 (gjashtëqind) Euro, të cilat dënime do të ekzekutohen në afat prej 15 ditëve, pasi që aktgjykimi të bëhet i formës së prerë, si dhe

-M.K., për shkak të veprës penale posedimi i pa autorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge, nga neni 269 par.1 të KPK, dhe i është shqiptuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 60 (gjashtëdhjetë) ditëve, si dhe dënimin me gjobë në shumën prej 250 (dyqindpesëdhjetë) Euro, të cilat dënime do të ekzekutohen në afat prej 15 ditëve, pasi që aktgjykimi të bëhet i formës së prerë.

Nëse të akuzuarit e lartcekur nuk dëshirojnë ose nuk mund ta paguajnë dënimin me gjobë, gjykata, dënimin me gjobë të shqiptuar secilit të akuzuar, do ti zëvendëson në dënim me burgim, duke llogaritur për çdo ditë të kaluar në burg, nga 20 (njëzetë) Euro.

Koha e kaluar në paraburgim prej datë 21.09.2023 e deri me 18.12.2023, do ti llogaritet në dënimin e shqiptuar me burgim të akuzuarin Sh.I., ndërsa koha e kaluar në arrest shtëpiak për të akuzuarën M.K. prej datë 21.09.2023 e deri me 15.11.2023, do ti llogaritet në dënimin e shqiptuar me burgim.

Ndaj të akuzuarve, konfiskohet, lënda narkotike me peshë prej 16.06 gram heroinë e përzier me kafeinë dhe paracetamol, një peshore elektrike dhe një foli, të cilat do të shkatërrohen pasi që ky aktgjykim të marrë formën e prerë si dhe shuma e të hollave prej 220(dyqind e njëzet) Euro.

Janë obliguar të akuzuarit që të paguajnë shpenzimet e procedurës penale, sado që të jenë ato sipas llogarisë së bërë në arkë të gjykatës secili veç e veç, paushallin gjyqësor në shumën prej nga 30€, si dhe shumën prej nga 50 €, për fondin për kompensimin e viktimave të krimit, në afat prej 15(pesëmbëdhjetë) ditësh, pasi që ky aktgjykim të marrë formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Kundër këtij aktgjykimi, në afatin ligjor, ankesë kanë ushtruar:

-Prokuroria Themelore në Gjiilan, për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, dhe ka propozuar që aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjiilan – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.194/2023, i dt.18.12.2023, të ndryshohet, ashtu që të akuzuarit ti shqiptohet dënim me burgim më i ashpër, si dhe dënimi me gjobë më i lartë,

-mbrojtësi i të akuzuarit Sh.I., av.Fitim Kosumi, për shkak të vendimit për dënimin, duke propozuar që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të ndryshohet dhe të akuzuarit ti shqiptohet dënim më i butë, ngase në këtë çështje penale ka rrethana lehtësuese të bollshme të cilat mund të ndikojnë që të akuzuarit ti shqiptohet dënim më i butë, me burgim,

-mbrojtësi i të akuzuarës M.K., av.Musli Maloku, për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, duke propozuar që të akuzuarës ti shqiptohet dënim më i butë, mundësisht dënim alternativ, ashtu që dënimin me gjobë ta kushtëzoj me kusht minimal, ose ta zëvendësoj me urdhër për punë në dobi të përgjithshme pasi që e akuzuara, është e gjendjes materiale jo të mirë.

-Përgjigje në ankesë të Prokurorisë Themelore në Gjilan, ka ushtruar mbrojtësi i të akuzuarit Sh.I., av.Fitim Kosumi, dhe ka propozuar që ankesa e ushtruara nga ana e Prokurorisë Themelore në Gjilan, të refuzohet si e pabazuar.

Prokuroria e Apelit në Prishtinë, me shkresën PPA/I.nr.129/2024, të datës 05.03.2024, duke u sqaruar përkitazi me ankesën e ushtruar nga ana e Prokurorisë Themelore në Gjilan – Departamenti për Krime të Rënda, ka propozuar që e njëjta të aprovohet si e bazuar, kurse të akuzuarve Sh.I. dhe M.K., tu shqiptohen dënime më të ashpra me burgim, si dhe dënime më të larta me gjobë.

Sa u përket ankesave të mbrojtësve së të akuzuarit Sh.I., av.Fitim Kosumi dhe M.K., av.Musli Maloku, të njëjtat të refuzohen si të pabazuara, sikurse edhe përgjigja në ankesë e mbrojtësit së të akuzuarit Sh.I., av.Fitim Kosumi, të refuzohet si e pabazuar.

Në kuptim të nenit 390 të KPPK, kolegji i kësaj gjykate ka caktuar seancën e kolegjit për dt.04.09.2024, dhe i ka njoftuar në mënyrë të rregullt të gjitha palët nga shkresat e lëndës.

Në seancë të kolegjit ka prezantuar, mbrojtësi i të akuzuarit M.K., av.Musli Maloku, dhe ka propozuar që të akuzuarës ti shqiptohet dënim më i butë, sikurse është një dënim alternativ.

Nuk ka prezantuar i akuzuari Sh.I., e akuzuara M.K., mbrojtësi i të akuzuarit Sh.I., av.Fitim Kosumi, prokurori i shtetit, përkundër asaj që kanë qenë të njoftuar në mënyrë të rregullt e cila vërtetohet nga shkresat e lëndës.

Gjykata e Apelit në kuptim të nenin 394 të KPPK, duke vlerësuar pretendimet ankimore nga ankesat e ushtruara, nga ana e Prokurorisë Themelore në Gjilan, mbrojtësve së të akuzuarve, Sh.I., av.Fitim Kosumi dhe M.K., av.Musli Maloku, propozimit me shkrim të Prokurorisë së Apelit në Prishtinë, aktgjykimit të ankimuar, si dhe shkresave tjera të lëndës ka gjetur se:

Ankesat, e Prokurorisë Themelore në Gjilan, si dhe mbrojtësve së të akuzuarve, Sh.I., av.Fitim Kosumi dhe M.K., av.Musli Maloku, nuk janë të bazuara

Meqenëse aktgjykimi i gjykatës së shkalës së parë nuk është ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, si dhe shkeljeve të ligjit penal, kolegji i kësaj gjykate e ka shqyrtuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, si dhe shkresat e tjera të lëndës, dhe ka ardhur në përfundim se i njëjti nuk përfshihet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, të parapara në kuptim të nenit 384 të KPPK, për të cilat shkelje kolegji i Gjykatës së Apelit, përkujdeset sipas detyrës zyrtare në pajtim të nenit 394 të KPPK, dhe ka ardhur në përfundim se i njëjti nuk përfshihet me shkeljet e pretenduara, të cilat do të kushtëzonin anulimin e tij, si dhe shkeljet e ligjit penal, për të cilat kjo gjykatë kujdeset kryesisht sipas detyrës zyrtare.

Sipas ankesës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është ankimuar për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, duke theksuar se në këtë

çështje penale, gjykata e shkallës së parë, t akuzuarve nuk u ka shqiptuar dënimet në proporcion me veprat penale të cilat u vihen në barrë secilit të akuzuar dhe se rrethanave lehtësuese u ka dhënë theksimin më të fortë, kurse rrethanat lehtësuese nuk i ka vlerësuar në masë të duhur, sidomos duke pasur parasysh mënyrën e kryerjes së veprave penale, si dhe shkallën e intensitetit të të njëjtave, për çka mendojmë se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë duhet të ndryshohet përkitazi me vendimin për dënimin, sikurse ati me burgim, po ashtu edhe ai me gjobë dhe të akuzuarve tu shqiptohen dënime më të ashpra, me të cilat do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit.

Mbrojtësi i të akuzuarit Sh.I., av.Fitim Kosumi, aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, e ka ankimuar për shkak të vendimit për dënimin, duke pretenduar se në këtë çështje penale gjykata e shkallës së parë të akuzuarit nuk i ka shqiptuar dënim që është në proporcion me veprën penale, ngase rrethanat lehtësuese të cilat janë të bollshme përkitazi me të akuzuarin Sh.I., se i njëjti është i moshuar, se është i gjendjes së varfër ekonomike, se është familjar, me sëmundje përcjellëse, se ka pasur sjellje korrekte, andaj me një vlerësim më përmbajtjesor të këtyre rrethanave ka pasur mundësi ligjore që të aplikohet instituti për zbutjen e dënimit, konform nenit 72 par.1 nën par.1.4 të KPPK, ngase me një dënim më të butë, do të arrihej efekti dhe qëllimi i dënimit.

Pasi që i njëjti përfshihet me këto shkeljet të cilat ndërlihen edhe me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384 pat.2 nën par.2.1 të KPPK, atëherë propozoj që të anulohet aktgjykimi i ankimuar dhe ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje, ose që i njëjti të ndryshohet dhe të akuzuarit ti shqiptohet dënim më i butë, sikurse me burgim, ashtu edhe me gjobë.

Po ashtu edhe mbrojtësi i të akuzuarit M.K., av.Musli Maloku, ka ushtruar ankesë për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, duke pretenduar se në këtë çështje penale edhe pse e akuzuara ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, i ka shqiptuar dënim të ashpër, me të cilin jemi të bindur se nuk do të arrihet efekti dhe qëllim i dënimit. Gjykata e shkallës së parë, ka ra në kundërshtim me rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit, sipas neneve 69,70 e 71 të KPK, andaj si rezultat i shkeljeve të së njëjtëve edhe vendimi për dënim me burgim dhe me gjobë, janë të ashpra, andaj propozon që të zëvendësohet dënimi me gjobë në një dënim më të butë, sikurse edhe dënimi me burgim dhe të akuzuarës ti shqiptohet dënim më i ulët.

Kolegji i kësaj gjykate ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë lidhur me vendimin për dënimin, si dhe shkresat e tjera të lëndës, sipas ankesave të ushtruara, nga ana e prokurorisë, mbrojtësve së të akuzuarve, Sh.I., av.Fitim Kosumi dhe M.K., av.Musli Maloku, dhe ka ardhur në përfundim se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk përfshihet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, si dhe shkeljet e ligjit penal, se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, e cila vërtetohet nga shkresat e lëndës, e sidomos nga pranimi i fajësisë, nga ana e të akuzuarve, ashtu që gjykata e shkallës së parë, me rastin e marrjes së vendimit për dënimin i ka vlerësuar të gjitha rrethanat sikurse ato lehtësuese po ashtu edhe ato rënduese, në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPK, e sidomos ka vlerësuar rrethanat lehtësuese, se të akuzuarit kanë pranuar fajësinë secili për veprën penale e cila i vihet në barrë, se që të dy kanë shpreh keqardhje për veprën e kryer, se kanë premtuar që në të ardhmen nuk kanë me ra në

kundërshtim me ligjin, kurse si rrethana lehtësuese ka vlerësuar mënyrën e kryerjes së veprës penale, si dhe shkallën e intensitetit të kryerjes së të njëjtave.

Po ashtu ka vlerësuar edhe dispozitat ligjore nga neni 71 lidhur me nenin 72 të KPK, përkitazi me zbutjen e dënimeve si dhe kufijtë e zbutjes së dënimeve, mirëpo ka vlerësuar se nuk ka rrethana posaçërisht lehtësuese për të aplikuar institutin e zbutjes së dënimit, brenda kufijve të zbutjes, sepse dënimet e shqiptuara janë në proporcion me peshën e veprave penale të kryera, si dhe janë vlerësuar në mënyrë të drejtë dispozitat ligjore të theksuara.

Nga ankesa e prokurorisë nuk ka gjetur ndonjë rrethanë posaçërisht rënduese, sikurse nuk ka gjetur edhe nga ankesat e mbrojtësve së të akuzuarve, Sh.I., av.Fitim Kosumi dhe M.K., av.Musli Maloku, ndonjë rrethanë posaçërisht lehtësuese, andaj duke vlerësuar mënyrën e kryerjes së veprave penale, si dhe shkallën e intensitetit të kryerjes së të njëjtave, të akuzuarve u ka shqiptuar dënimet sikurse në dispozitiv të aktgjykimit, ashtu që kolegji është i bindur që me dënimin e shqiptuar të akuzuarve, sikurse në dispozitiv të aktgjykimit, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tyre, që të parandalojë kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, të paraparë në nenin 41 të KPK-së.

Nga sa u tha më lartë e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPPK, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.119/2024, të datës 04.09.2024

Procesmbajtëse,
Nderime Shkodra

Anëtarët e kolegjit,
Hashim Çollaku

Kryetari i kolegjit,
Xhevdet Abazi

Mentor Bajraktari